

EUROPA

DREJTOR: ALBERT RAKIPI • KRYEREDAKTOR: MARSIDA GJONÇAJ • SHEFE E MARREDHENIEVE ME JAShte: ADELA HALO

Pikniku që ndikoi në ndryshimin e Europës



Angela Merkel, kancelaria e parë gjermane nga ish Gjermania Lindore, e lëvdoi Hungarinë për organizimin e asaj ngjarje të 20 viteve më parë, e cila çoi në rënien e murit të Berlinit dhe bashkimin e vendit të saj. Merkel tha se Pikniku mbarë-Europian i 1989, një demonstratë paqësore pranë kufirit austriak që gjermanët lindorë e shfrytëzuan për t'u arratisur drejt perëndimit, ishte me rrezik por tepër e guximshme. "Atë çka bënë hungarezët ishte e guximshme," shton Merkel në përvjetorin e kësaj ngjarjeje. "Dy kombe të skllavëruar i shembën muret e skllavërimit ... dhe ishin hungarezët ata që i dhanë krahë dëshirës së gjermano-lindorëve për liri. "Hapja e kufijve ishte një ngjarje që nuk njohu kthim dhe disa vite më pas u rëzuan edhe muret e Luftës së Ftohtë." Në piknik, Hungaria planifikoi t'i hapte kufijtë me Austrinë për tre orë, në mënyrë simbolike, por qindra gjermanë lindorë, të cilët ishin mbledhur me shpresën për t'u arratisur, u turrën para se të bëhej hapja zyrtare. Rojet e kufirit hungarez kishin urdhër të qëllonin por ata nuk ndërhynë dhe e mbajtën kufirin hapur për disa orë, duke e kthyer këtë akt sot në një moment historik mes ngjarjeve që çuan në rënien e Murit të Berlinit. Brenda një muaji, më 11 Shtator, Hungaria i hapi zyrtarisht kufijtë me Austrinë dhe sipas historianëve, nga Nëntori, kur Muri i Berlinit ra, mbi 60,000 gjermanë lindorë kishin ikur përmes Hungarisë. "Pikniku çoi në një hapje të shkurtër të Perdes së Hekurt dhe ndikoi në rënien përfundimtare të saj si edhe në bashkimin paqësor të Gjermanisë," thotë në një deklaratë Presidenti i Komisionit European Jose Manuel Barroso. "Pikniku në Sopron shënoi në këtë mënyrë fillimin e fundit të ndarjes së Europës nga Lufta e Ftohtë." Presidenti hungarez Laszlo Solyom tha se pikniku ishte një hap përpara për gjithë...

FAQE 13

Në këtë numër:

Liberalizimi i vizave, plani i veprimit të Shqipërisë

FAQE 8

Dita e parë Botërore e aktiviteteve Humanitare

FAQE 3

FMN: Kriza ekonomike globale po rimëkëmbet

FAQE 10

Sekreti i turizmit të Greqisë

FAQE 16

ME MBESHTETJEN E FONDACIONIT SHOQERIA E HAPUR PER SHQIPERINE (FONDACIONI SOROS, OSFA)

